



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

V E N D I M

Nr. 156, Datë 28/07/2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën nr. 37, datë 04.02.2022, së z. A.P., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*” nga ana Akademisë së Sigurisë.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, z. A.P. ka përfunduar në vitin 2018, studimet Bachelor për “Shkenca Juridike në Biznes” pranë Fakultetit Ekonomik, të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Në vijim, ankuesi ka përfunduar studimet në programin Master Profesional në të Drejtën Publike pranë Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës dhe është diplomuar në muajin korrik të vitit 2021. Mbështetur në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ankuesi ka aplikuar për pranim pranë Akademisë së Sigurisë, si student që ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë më mesatare të notave mbi 8 (tetë).

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Për sa më sipër, ankuesi i është nënshtruar konkurrimit dhe procedurave përkatëse të parashikuara në aktet nënligjore respektive, sikurse të gjithë aplikantët e tjerë, deri në momentin që i është komunikuar, që Komisioni i Vlerësimit e ka skualifikuar, pasi nuk plotësonte kriterin shëndetësor të shikimit 10/10. Z. A.P. e ka konsideruar të padrejtë dhe diskriminues skualifikimin e tij dhe e ka kundërshtuar këtë vendim pranë Komisionit të Apelit, i cili ka konfirmuar skualifikimin e tij.

Z. A.P. shprehet se nuk është njoftuar paraprakisht, lidhur me kriterin e shikimit 10/10 para apo edhe gjatë aplikimit të tij për në Akademinë e Sigurisë. Ai sqaron se ky kriter nuk është i shënuar as në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të Aspa-s dhe as nuk është i parashikuar në Urdhërin nr. 888, datë 27.09.2021, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë”*. Në këtë kontekst, ai pretendon se është skualifikuar në bazë të një kriteri të papërcaktuar në asnjë akt nënligjor apo administrativ. Z. A.P. sqaron gjithashtu se në ndryshim me njoftimin për aplikim për Akademinë e Sigurisë për shtetasit që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, në njoftimin e publikuar për aplikim në Shkollën Bazë të Policisë për Patrullë të Përgjithshme, kriteri i shikimit është i mirëpërcaktuar në rastet e skualifikimit.

Z. A.P. shprehet gjithashtu se mungesën e informacionit nga ana e Akademisë së Sigurisë e ka konstatuar edhe në aspekte të tjera. Kështu ankuesi shprehet se në konkursin për patrullën e përgjithshme, të gjithë rezultatet dhe pikët e konkurrentëve janë publikuar në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit, ndërkohë përsa i përket rezultateve të konkursit të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, nuk ka asnjë publikim të tillë. Ai pretendon se gjithashtu se çdo komunikim për vijimin e procedurave të konkurimit është bërë në mënyrë private nëpërmjet kontaktimit me celular.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon konstatimin e diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore (shikimit) nga ana e Akademisë së Sigurisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*gjendjes shëndetësore*” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e arsimit. Ky ligj në nenin 17, pika 1, gërma ç) të tij parashikon se: “Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.”

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A. Pas analizimit të ankesës nr. 37, datë 04.02.2022, e z. A.P., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B. Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Akademisë së Sigurisë dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe ankuesit, me shkresën nr. 259/1 Prot., datë 11.02.2022, ku kërkohej informacion mbi çështjen e parashtruar nga subjektet ankuese.
1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
 2. Informacion nëse kriteri i shikimit 10/10 për shtetasit, që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe që aplikojnë për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë, është i përcaktuar në ndonjë akt administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Nëse po, të përcillet akti përkatës, si dhe të jepen shpjegimet përkatëse përse nuk është shënuar dhe specifikuar një kriter i tillë në njoftimin për aplikim;
 3. Kopje të njoftimit për aplikim pranë Akademisë së Sigurisë për shtetasit, që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe që aplikojnë për t’u pranuar në të;
 4. Kopje të njoftimit për aplikim pranë Akademisë së Sigurisë për shtetasit, që aplikojnë për t’u pranuar në Shkollën Bazë të Policisë për Patrullë të Përgjithshme;
 5. Kopje të akteve të njoftimit të dërguara në adresë të ankuesit, për secilën prej fazave të konkurimit pranë Akademisë së Sigurisë;
 6. Kopje të aktit, ku është kryer kontrolli i shikimit të shtetasit A.P.;
 7. Vendimi për skualifikimin e z. A.P. dhe Vendimin e Komisionit të Apelit nëpërmjet së cilit është lënë në fuqi vendimi i Komisionit të Vlerësimit;
 8. Lista e aplikantëve që janë skualifikuar me të njëjtin motivacion, sikurse ankuesi;
 9. Lista e aplikantëve të skualifikuar, përgjatë konkurimit të sipërcituar, duke evidentuar arsyen e skualifikimit të secilit prej tyre.
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të Komisionerit, Akademia e Sigurisë dërgoi shkresën nr.259/2, datë 23.02.2022, nëpërmjet së cilës informon se aplikanti A.P. ka aplikuar për

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me regjistrimin e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve pune nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër.”*

pranim pranë Akademisë së Sigurisë, mbështetur në Urdhërin nr. 888, datë 27.09.2021, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit *“Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë”*, ku ka kaluar me sukses, fazën e vlerësimit të dokumentacionit, fazën e testimit të njohurive në gjuhën angleze sipas standardit ALCPT, si dhe fazën e intervistës. Në fazën e kontrollit shëndetësor, aplikanti është skualifikuar, vërtetuar kjo me Procesverbalin nr. 660/8, datë 22.12.2021 *“Mbi shpalljen nga ana e Komisionit të Kontrollit Mjekësor të kandidatëve që kalojnë në fazat e tjera të konkurimit për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë”*. Ky Komision është ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Pas ankesës së bërë nga ankuesi A.P. dhe disa aplikantë të tjerë, në datën 28.12.2021 u mbledh Komisioni i Apelimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku me Vendimin nr.322, datë 30.12.2021, ka vendosur rrëzimin e ankesës së ankuesit, pasi ai nuk plotëson kriteret e miratuara. Ky vendim i është vënë në dispozicion z. A.P., kundrejt nënshkrimit në regjistrin përkatës në datën 05.01.2022. Në lidhje me specifikimin e kriterit të shikimit 10/10 për shtetasit që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe që aplikojnë për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë, ky është një kriter i përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe jo nga Akademia e Sigurisë.

Në lidhje me njoftimet për çdo fazë të këtij procesi, Akademia e Sigurisë sqaron se njoftimi i aplikantëve është kryer konform procedurës përkatëse, duke i njoftuar ata në një nga mënyrat e komunikimit, në telefon, e-mail, të dhëna të cilat janë në administrim të Akademisë së Sigurisë. Në të gjitha fazat e konkurimit, aplikantët janë njoftuar me telefon, sipas numrit të shënuar në aplikim. Në rast të mos komunikimit me telefon, aplikantët janë njoftuar me anë të adresës së e-mailit. Në lidhje me këto njoftime, asnjë prej aplikantëve nuk ka patur pretendime të shprehura deri më sot.

Akademia e Sigurisë ka vënë në dispozicion të KMD-së aktet e mëposhtëme:

1. Kopje e njoftimit për aplikim, konkretisht Urdhërin nr. 888, datë 27.09.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit *“Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të Arsimit të Lartë”*.
2. Kopje e njoftimit për aplikim, konkretisht Urdhërin nr.846, datë 15.09.2021, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurrim, për pranim në Kolegjin Profesional të Formimit Policor , në Akademinë e Sigurisë”*.
3. Kopje e Urdhërit nr. 888/1, datë 26.11.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për vlerësimin dhe verifikimin e shtetasve, që kanë aplikuar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe kanë aplikuar për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë”*.

4. Kopje e Procesverbalit të Sektorit të Profilaksi Mjekimit nr. 660/8 prot., datë 22.12.2021, *“Mbi shpalljen nga ana e Komisionit të Kontrollit Mjekësor, të kandidatëve që kalojnë në fazat e tjera të konkurrimit për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë”*;
 5. Kopje të ankimit nr. 11, datë 22.12.2021, të aplikantit A.P.;
 6. Kopje e procesverbalit nr. 315, datë 30.12.2021, të Komisionit të Apelimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
 7. Kopje e vendimit nr. 315, datë 20.12.2021, të Komisionit të Apelimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
 8. Lista e aplikantëve të skualifikuar në këtë proces.
- Në përgjigje të shkresës së KMD-së, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dërgoi shkresën nr. 1151/1, datë 25.02.2022, ku sqaron se në datën 20.12.2021, kandidati A.P., është paraqitur pranë Qendrës së Profilaksisë dhe Mjekimit për kontrollin shëndetësor në Akademinë e Sigurisë.

Mbështetur në Urdhërin nr. 888/1, datë 26.11.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është ngritur Komisioni Shëndetësor, pranë Akademisë së Sigurisë, duke marrë në shqyrtim të gjitha ekzaminimet e kryera, konstatoi se kandidati për pranim, shtetasi Alban Vangjel A.P. ka problem me sytë, në vizusin e syrit të majtë, sipas diagnozës (OS 7/10 dhe OD – 7/10 OU 7/10).

Mbështetur në Procedurat Standarde të Pranimit në Akademinë e Sigurisë, të miratuara me Urdhërin nr. 948, datë 17.12.2015, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Komisioni Shëndetësor citon se: *“Çdo aplikant duhet të ketë shikim 10/10 në çdo sy” “Çdo aplikant duhet të jetë në gjendje të dallojë ngjyrat bazë, të përcaktuara me anë të një testi si dhe të ketë fushë vizive normale”*.

Mbi bazën e akteve normative, në të cilat vepron Policia e Shtetit, Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.06.2015, i ndryshuar, Komisioni Shëndetësor, me Vendimin nr. 11, datë 22.12.2021, vendosi: *“Aplikanti A.P. nuk kualifikohet për të vazhduar në fazat e tjera për në Akademinë e Sigurisë, pasi konsiderohet i paafte për të vazhduar studimet në Akademinë e Sigurisë. Gjatë rekrutimit të aplikantëve, ata duhet të kenë shëndet të plotë, nuk duhet të kenë kryer asnjë operacion në sy, të mos kenë shenja, plagë rreth syve dhe të kapakëve të syve.”*

Komisioni i Apelimit, i ngritur me Urdhërin nr. 888/1, datë 26.11.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për vlerësimin dhe verifikimin e shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studentëve të arsimit të lartë dhe kanë aplikuar për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë”*, pasi ka shqyrtuar ankimin e paraqitur, ka vendosur se: *“Aplikanti z. Alban Vangjel A.P. nuk plotëson kriterin e shikimit”*. Në këto kushte, mbështetur në pikën 4/4 të Urdhërit nr. 888, datë 27.09.2021, të Drejtorit të

Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të Arsimit të Lartë”, si dhe Procedurën Standarde “Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të Policisë”, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, kanë vendosur rrëzimin e ankesës së z. A.P., pasi nuk plotëson kriteret e mësipërme. Aplikanti është njoftuar për vendimin e marrë nga Komisioni i Apelit, bazuar në Vendimin nr. 322, datë 30.12.2021.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka dërguar aktet e mëposhtëme:

1. Kopje e kartelës mjekësore të aplikantit A.P.;
 2. Vendimin nr. 11, datë 22.12.2021, të Komisionit Shëndetësor;
 3. Vendimin nr. 322, datë 30.12.2021, të Komisionit të Apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
 4. Kopje e Urdhërit nr. 888, datë 27.09.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të Arsimit të Lartë”;
 5. Listën e aplikantëve të shpallur në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit;
 6. Procesverbal i shpalljes nga Komisioni i Kontrollit Mjekësor të kandidatëve, që kalojnë në fazat e tjera të konkurrimit, për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë.
- Në vijim të procedurave hetimore, KMD vendosi realizimin e seancës dëgjimore në datën 27.04.2022, ora 11:00. Në këtë seancë u ftua për pjesëmarrje edhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Palët u njoftuan për seancë, nëpërmjet shkresës nr. 259/4 Prot., datë 04.04.2022, së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit z. B.L., përfaqësuesi me autorizim i Akademisë së Policisë dhe i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe ankuesi A.P.. Ankuesi parashitroi edhe një herë pretendimet e tij për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore.

Ankuesi kreu një përmbledhje të ankesës dhe pretendimeve të tij. Ai u shpreh se pasi ka marrë dijeni mbi njoftimin përkatës ka aplikuar për të konkuruar në Akademinë e Policisë. Në muajin dhjetor 2021 ka marrë njoftim për fillimin e procedurave për fazat e konkurimit. Faza e parë ka qenë provimi i anglishtes të cilin e ka kaluar suksesshëm. Komunikimet për fazat pasardhëse janë bërë nëpërmjet telefonit. Pas kryerjes së intervistës, i është thënë që do i merreshin shenjat e gishtave dhe do të firmosej kontrata përkatëse, ndërkohë që do të kryhej edhe testi i shikimit. Në fillim të këtij testi, ankuesi pretendon se komisioni përkatës i ka vënë në dukje faktin se ai mbante syze dhe një nga anëtarët është shprehur se “Ne nuk i duam me syze”. Ankuesi sqaron se është shprehur para komisionit se ai nuk kishte dijeni mbi këtë fazë, pasi nuk parashikohej si e tillë në Rregullore dhe ndonjë urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ndërkohë që nga Komisioni i është

pohuar e kundërta. Në test ka rezultuar se shikimi i tij nuk i arrinte parametrat 10/10. Ankuesi u shpreh se ka dijeni që testi i shikimit kryhet për aplikantët për patrullën e përgjithshme, por jo për aplikantët që konkurronin sikurse ai. I pyetur nëse të gjithë aplikantët iu nënshtroan këtij testi, ankuesi e pohoi këtë fakt. Ankuesi sqaroi gjithashtu se në njoftimin e publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ishte cilësuar që aplikantët do t'i nënshtroheshin këtij testi, ndërkohë që në njoftimin për patrullën e përgjithshme, testi i shikimit ishte i përcaktuar shprehimisht në të. Ankuesi sqaron se ka apeluar administrativisht vendimin e komisionit, por Komisioni i Apelit e ka rrëzuar kërkesën e tij, duke u mbështetur në nenin 4, pika 1, të Urdhërit nr. 888/2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në fakt ka qenë neni 5/1, por ishte një lapsus ose gabim material i Komisionit të Apelit.

Ankuesi u shpreh se kriteri i shikimit nuk duhet të jetë kriter skualifikimi, pasi oficerët e policisë në detyrë gjatë veprimtarisë së tyre kryejnë kontroll vjetor të shikimit dhe shumë prej tyre përdorin syze. Forcat e posaçme kryejnë kontroll të shikimit çdo 6 muaj. Ai u shpreh se po aplikonte për policinë shkencore, ku ka shumë punonjës policie me syze dhe se në dijeninë të tij personat që përfundonin këtë cikël studimi, merrnin gradën nënkomisar dhe mund të punonin në komisarate të ndryshme në punë administrative. Z. A.P. sqaroi se qëllimi i tij ishte të diplomohej pranë Akademisë së Sigurisë dhe të punonte oficer policie gjyqësore dhe të paturit syze nuk do të ndikonte në punën e tij, pasi puna që do të kryente do të ishte *quazi* administrative. Ndërkohë që, kursi për patrullë e përgjithshme e kishte të cilësuar testin për kriterin e shikimit.

Përfaqësuesi i subjekteve u shpreh se ankuesi ka aplikuar në një cikël studimi për studentët e ekselencës që zgjaste 6 muaj dhe kishte 2 vjet që zbatohet. Njëkohësisht, ai i informoi të pranishmit në seancë duke theksuar se Akademia e Sigurisë është një institucion varësie i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe është i vetmi institucion i lartë i policisë së shtetit, në fushën e sigurisë publike. Që nga viti 2012, ky institucion është më i lartë se institucionet IAL, pasi nuk ofron vetëm arsimim të oficerëve të rinj të policisë, por ofron gjithashtu edhe kualifikime dhe trajnime për ta. Hapat e para që duhet të ndjekë një civil, për t'u bërë pjesë e sistemit të gradave policore, është ndjekja e Kolegjit të Posaçëm të Patrullës së Përgjithshme ose Kolegji i Lartë Profesional. Ata që ndjekin kursin e Patrullës së Përgjithshme, vetëm pas disa vitesh praktike në punë, mund të ndjekin nivelin bachelor në Akademinë e Sigurisë, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, duke plotësuar disa kriteret e caktuara. Kandidatët që përfundojnë nivelin Bachelor pranë Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit marrin gradën Nënkomisar. Pranë Akademisë së Sigurisë është hapur edhe një kurs për studentët ekselentë, me mesatare mbi 8, të cilët me ezaurimin e fazave të kualifikimit dhe vazhdimin e studimeve në këtë akademi do të fitojnë gradën Nënkomisar, gradë, e cila për kandidatët që ndjekin kurse të tjera pranë kësaj akademie, fitohet pas shumë vitesh praktikë në punë. Personat që përfundojnë Akademinë e Sigurisë do të ushtrojnë funksionet sipas gradës Nënkomisar pranë vendit të aplikimit, komisarariatit të policisë respektiv, ku kanë aplikuar ose aty ka nevojë shërbimi policor.

Policia e Shtetit është një institucion i centralizuar, në bazë të nenit 9/1 të ligjit për policinë e shtetit. Ky institucion funksionon në bazë të legjislacioni në fuqi, ku bëjnë pjesë edhe urdhërat e titullarit. Në vitin kur ka aplikuar pala ankuese, kanë qenë në fuqi dy urdhëra të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, përkatësisht Urdhëri nr. 888/2021 dhe Urdhëri 888/1/2021, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që normojnë procedurën e pranimi në Akademinë e Sigurisë. Urdhëri nr. 888/2021, i Drejtorit të Përgjithshëm përcakton shpalljen e aplikimeve në akademinë e sigurisë për studentët e ekselencës, ndërkohë që Urdhëri 888/1/2021, përcakton procedurat për studentët e ekselencës që aplikojnë për ndjekjen e arsimit pranë kësaj akademie. Këto janë dhe 2 aktet që rregullojnë procedurat e pranimi të studentëve të ekselencës në Akademinë e Sigurisë. Një nga kriteret e pranimi në Akademinë e Sigurisë, jo vetëm për kandidatët për patrullën e përgjithshme, por edhe për ata që i përkasin kategorisë së studentëve të ekselencës është edhe kriteri shëndetësor. Neni 38/ç, i ligjit për policinë e shtetit e përcakton mjaft qartë se kriteri shëndetësor është një kriter që duhet ta plotësojë çdo aplikant, që do të pranohet në Akademinë e Sigurisë. Dy aktet kryesore mbi bazën e së cilëve funksionon policia e shtetit janë ligji për policinë e shtetit dhe rregullorja e policisë së shtetit. Ndërkohë që, ka edhe akte të tjera, nënligjore siç është rregullorja e shërbimit shëndetësor, miratuar me Urdhërin nr.983, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, që rregullon të gjithë sektorin e profilaksi mjekimit. Të gjitha rekrutimet për në Akademinë e Sigurisë, për çdo kurs të ndjekur, mbështeten në këtë rregullore dhe duhet të plotësojnë të njëjtat kriteret shëndetësorë dhe një gjë e tillë është bërë edhe për efekt mosdiskriminimi. Kriteri shëndetësor është kriter bazik për të gjithë pranimet në Akademinë e Sigurisë. Pika 5 e Rregullores së Shërbimit Shëndetësor nr. 983, parashikon edhe kriterin okulistik, pra kriterin e shikimit.

I pyetur lidhur me faktin e pretenduar nga ankuesi se në njoftimin për aplikantët e patrullës së përgjithshme është përcaktuar faza e testimit të shikimit, ndërkohë që tek njoftimi për aplikantët studentë ekselence, një test i tillë nuk është përcaktuar, përfaqësuesi i Akademisë së Sigurisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit sqaroi se kriteret mjekësore janë të njëjta për të gjithë aplikantët për të gjitha kurset, pasi edhe ata studentë, që ndjekin kursin për patrullë e përgjithshme, pas disa vitesh do të aplikojnë për të kryer nivelin Bachelor pranë Akademisë. Në këtë kontekst, kriteri shëndetësor, ku përfshihet edhe ai okulistik është i njëjtë për të gjithë. I pyetur se si është renditur në listën e procedurës së fazave të konkurrimit kriteri shëndetësor, pasi aplikanti ka kaluar me sukses të gjitha fazat dhe ka rezultuar jokalues tek ky kriter, përfaqësuesi i institucioneve u përgjigj se kjo është një fazë konkurrimi, si gjithë të tjerat dhe nuk ka rëndësi renditja e saj.

Lidhur me ndryshimet ndërmjet dy njoftimeve, përfaqësuesi i Akademisë së Sigurisë dhe Policisë së Shtetit shprehet se njoftimi për patrullë të përgjithshme ka qenë më sqarues dhe i hollësishëm, pasi kontigjenti i aplikantëve për patrullë të përgjithshme vjen nga shkollat e mesme, ndërkohë që studentët e ekselencës kanë nivel tjetër dhe është e konsideruar e panevojshme që pjesë e këtij njoftimi të jetë i gjithë Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Tek kriteret skualifikuese tek patrulla e përgjithshme është specifikuar shprehimisht mosplotësimi i kriterit të

shikimit, ndërkohë që një kriter i tillë nuk është caktuar tek njoftimi për studentët ekselentë. Përfaqësuesi i subjekteve u shpreh se edhe tek njoftimi për studentët ekselentë është përcaktuar plotësimi i kriteri shëndetësor edhe pse nuk është elaboruar hollësisht, sikurse tek njoftimi për patrullë të përgjithshme. Njëkohësisht, ai sqaron se lidhur me çështjen objekt ankimi është ezauruar gjyqësisht dhe padia e ankuesit është rrëzuar mbi një pretendim të tillë.

I pyetur se ku punësohen studentët ekselentë që përfundojnë kursin 6 mujor të Akademisë së Sigurisë, përfaqësuesi i subjekteve u shpreh se këta punojnë përgjithësisht në terren (70-80% e tyre punojnë në terren, me armë) dhe janë nënkomisarë të drejtorive vendore të zonave të ndryshme . Vetëm 20% e tyre mund të kryejnë detyrat e policisë rrugore. Kjo nënkupton që një person që ka probleme të shikimit mund të gabojë në qitje dhe në rast se gabon shënjestrën mund të ketë probleme të tjera, të cilat janë evidentuar në praktikë. Ulja e nivelit të kriterit të shikimit është fakt i diskutuar, por faktet e sipërpërmendura kanë bërë që të mos ndryshojë. Në seancë, përfaqësuesit të subjekteve iu kërkua të dërgojë informacion mbi mundësitë e punësimit të studentëve të ekselencës, pasi përfundojnë Akademinë e Sigurisë dhe si veprohet me ata punonjës policie në detyrë që mbajnë syze dhe nuk kanë shikim 10/10. Përfaqësuesi i subjekteve u përgjigj se ata punonjës policie që mbajnë syze, kur janë rekrutuar në Akademinë e Sigurisë nuk kanë patur probleme me shikimin. Problemet janë shfaqur më vonë dhe këta punonjës kryejnë detyra administrative, por jo në terren. Ankuesi theksoi faktin se ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, parashikon kontrollin vjetor të shikimit të punonjësve në detyrë. Përfaqësuesit e KMD-së e pyetën ankuesin lidhur me vendimmarrjen e gjykatës lidhur me çështjen e parashtuar nga z. A.P., ky i fundit u përgjigj se padia e tij është rrëzuar.

- Në vijim të seancës dëgjimore, KMD iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë nëpërmjet shkresës nr.259/5, datë 11.05.2022, ku kërkoi informacionin e mëposhtëm:

1. Informacion nëse kriteri i shikimit 10/10 vlen edhe për oficerët e policisë që janë në detyrë, pranë institucioneve të ndryshme në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
2. Mënyra se si procedohet për monitorimin e kriterit të shikimit të oficerëve të policisë, përgjatë viteve, që ata janë në detyrë;
3. Si veprohet nëse ata rezultojnë se nuk kanë shikim në parametrat 10/10 apo përdorin syze gjatë ushtrimit të detyrës?
4. Cilat janë mundësitë e punësimit të shtetasve, të cilët përfundojnë kursin 6 mujor pranë Akademisë së Sigurisë, pasi kanë përfunduar paraprakisht ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë.
5. Informacion mbi institucionet, ku janë punësuar, të diplomuarit e 3 viteve të fundit, të cilët kanë përfunduar ciklin studimor 6 mujor të Akademisë së Sigurisë.
6. Çdo informacion tjetër që e konsideroni të nevojshëm për çështjen objekt shqyrtimi;

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të KMD-së, Akademia e Sigurisë dërgoi shkresën nr. 985/1 prot., date 13.05.2022, nëpërmjet së cilës informon se struktura që ka për kompetencë dhënien e informacionit të kërkuar është Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Në përgjigje të shkresës së KMD-së, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dërgoi shkresën nr. 3586, datë 24.05.2022, ku sqaron se në datën 20.12.2021, kandidati për në Akademinë e Policisë A.P. është paraqitur pranë Qendrës së Profilaksisë dhe Mjekimit për Kontrollin Shëndetësor në Akademinë e Sigurisë.

Bazuar në Urdhërin nr. 888/1, datë 26.11.2021 e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është ngritur Komisioni Shëndetësor, pranë Akademisë së Sigurisë, që ka marrë në shqyrtim të gjitha ekzaminimet e kryera, konstatoi se kandidati për pranim, shtetasi A.P. ka probleme me sytë në vizusin e syrit të majtë, sipas diagnozës (OS 7/10 dhe OD – 7/10 OU 7/10).

Sa më sipër, Komisioni Shëndetësor pranë Akademisë së Sigurisë, mbështetur në Procedurat Standarde të Pranimit në Akademinë e Sigurisë, të miratuara me Urdhërin nr. 984, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, citon se: *“Çdo aplikant duhet të ketë shikim 10/10 në çdo sy”, “Çdo aplikant duhet të jetë në gjendje të dallojë ngjyrat bazë, të përcaktuara me anë të një testi si dhe të ketë fushë vizive normale”.*

Mbi bazën e akteve normative, në bazë të së cilave vepron Policia e Shtetit, e përkatësisht Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.06.2015, i ndryshuar, Komisioni Shëndetësor, me Vendimin nr. 11, datë 22.12.2021, vendosi: *“Aplikanti A.P. nuk kualifikohet për të vazhduar fazat e tjera për në Akademinë e Sigurisë.”* Gjatë rekrutimit të aplikantëve, ata duhe të kenë shëndet të plotë, nuk duhet të kenë kryer asnjë operacion në sy, të mos kenë shenja, plagë rreth syve dhe të kapakëve të syve.

Komisioni i Apelimit, i ngritur me Urdhërin Nr. 888/1, datë 26.11.2021, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për vlerësimin dhe verifikimin e shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studentëve të arsimit të lartë dhe kanë aplikuar për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë”*, pasi ka shqyrtuar ankimin e paraqitur, ka vendosur se aplikanti z. Alban Vangjel A.P. nuk plotëson kriterin e shikimit, sipas pikës 5 *“Kriteret okulistike”*, të Urdhërit nr. 984, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në këto kushte, bazuar në pikën 4/4 të Urdhërit nr. 888, datë 27.09.202, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe Procedurën Standard *“Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë”* miratuar me Urdhërin nr. 984, datë 17.12.2015, kanë vendosur rrëzimin e ankesës së aplikantit A.P., pasi nuk plotësohen kriteret e mësipërme.

Aplikanti është njoftuar për vendimin e marrë nga Komisioni i Apelit, bazuar në vendimin nr. 322, datë 30.12.2021.

Në nenin 136/1 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, përcakton se, struktura e përgjegjëse për kryerjen e kontrollit shëndetësor është Komisioni i Kontrollit Shëndetësor. Ndërkohë, neni 140 i Rregullores përcakton rastet e skualifikimit të kandidatit dhe konkretisht në të citohet si vijon: *“Aplikanti skualifikohet në rastet e mëposhtëme:*

- a) Nuk kalon testimin me shkrim;*
- b) Nuk kalon testimin e aftësive fizike;*
- c) Nuk kalon testin psikologjik;*
- d) Nuk paraqitet në kohën e caktuar në një nga fazat e testimit;*
- e) Ka deklaruar të dhëna të rreme apo ka paraqitur dokumente të falsifikuara.”*

Lidhur me kriterin e shikimit 10/10, nëse vlen ose jo edhe për oficerët e policisë që janë në detyrë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shteti sqaron se procedura standarde e sipërcituar vlen për aplikantët që rekrutohen në strukturat e Policisë së Shtetit, ndërkohë që për punonjësit e policisë, të cilët mund të kenë diagnoza të ndryshme shëndetësore trajtohen sipas ligjit *“Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor”* dhe me Kemp.

Për sa i përket mundësisë së punësimit të aplikantëve, ka kursantë që plotësojnë kriteret dhe i kalojnë me sukses fazat e testimit konform ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe Rregulloren e Policisë, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015.

Numri i kursantëve të pranuar në Akademinë e Sigurisë 3 (tre) vitet e fundit dhe që janë punësuar në Policinë e Shtetit, përgjatë këtyre viteve janë: viti 2019 -208 kursantë, viti 2020 – 578 kursantë, viti 2021 – 438 kursantë, në total – 1224 kursantë.

Lidhur me ankimin e z. A.P., Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit thekson faktin se ka fituar gjykimin në gjykatën administrative të shkallës së parë, e cila është shprehur me vendim duke e rrëzuar kërkesë padinë e z. A.P..

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat, të drejtat dhe statusin e Policisë së Shtetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullon veprimtarinë, marrëdhëniet e punës, garantimin e karrierës, mirëqenies dhe vazhdimësisë në detyrë të punonjësit të policisë. Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Policia e Shtetit është institucion i administratës shtetërore, person juridik në varësi administrative të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.

Në nenin 37 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, parashikohet se policia ka institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrative dhe menaxherial, që është Akademia e Sigurisë, e cila ofron specializime dhe kualifikime për institucione të tjera të zbatimit të ligjit, si dhe për persona fizikë e juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike. Në bazë të parashkimit të këtij neni, organizimi dhe funksionimi i Akademisë së Policisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në pikat 1-2 të nenit 38 të ligjit të sipërcituar parashikohet se:

1. *Pranimi në Akademinë e Sigurisë bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur.*
2. *Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasve në institucionin arsimor policor janë si më poshtë:*
 - a) *të jetë shtetas shqiptar;*
 - b) *të mos jetë i përjashtuar nga policia apo të jetë larguar nga shërbimi civil;*
 - c) *të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
 - ç) *të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;*
 - d) *të ketë mbaruar arsimin e mesëm;*
 - dh) *të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;*
 - e) *të mos jetë i dënuar me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;*
 - ë) *të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B.*

Për sa më sipër, rezulton se gjendja e mirë shëndetësore dhe aftësia fizike e kandidatit është një nga kriteret e përgjithshëm të pranimit të shtetasve në këtë Akademi.

Në nenin 17, pika 7, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet

shprehimsht se një nga llojet e institucioneve të arsimit të lartë është edhe Akademia. Referuar nenit 19, të këtij ligji, Akademia, është institucion i arsimit të lartë i profilizuar, që vepron në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. Referuar Statutit dhe Rregullores të Akademisë së Sigurisë, Akademia e Sigurisë është institucion publik i arsimit të lartë që synon arsimimin e punonjësve të policisë, që respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për arsimin e lartë dhe ligjin për Policinë e Shtetit.

Në bazë të pikave 1-2 të Vendimit nr. 185, datë 25.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë*” përcaktohet se Akademia e Sigurisë është institucion përgjegjës i vetëm i arsimit të lartë publik policor, që ka për mision formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe ofrimin e specializimeve dhe kualifikimeve për institucione të tjera të zbatimit të ligjit e për personat fizikë e juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike. Akademia e Sigurisë është institucion në përbërje të Policisë së Shtetit dhe e zhvillon veprimtarinë mësimore e kërkimore në funksion të nevojave që ka Policia e Shtetit.

Akademia e Sigurisë ka detyra dhe përgjegjësi që konsistojnë në: a) Formimin bazë të punonjësve të nivelit bazë të Policisë së Shtetit; b) përgatitjen e specialistëve të lartë të Policisë së Shtetit në të tre ciklet e studimeve universitare; c) kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit; ç) zhvillimin e kërkimeve e të studimeve në fushën e policimit dhe të sigurisë; d) ofrimin e specializimeve dhe kualifikimeve për institucione të tjera të zbatimit të ligjit dhe për personat fizikë e punonjësit e personave juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike. Referuar pikës 5 të VKM-së së sipërcituar, njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë janë Fakulteti i Sigurisë Publike, Fakulteti i Hetimit të Krimit dhe Qendra Kërkimore Shkencore.

Në Kreun II, të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, janë parashikuar procedurat e pranimit në Akademinë e Sigurisë. Në nenin 136 të kësaj rregulloreje përcaktohet se:

“1. Struktura përgjegjëse për menaxhimin e procesit të pranimit në Akademinë e Sigurisë, është Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

2. Struktura përgjegjëse për kryerjen e testimit me shkrim, testimit fizik, testimit psikologjik dhe intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimit të aftësive të të shkruarit, është Akademia e Sigurisë, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e Akademisë së Sigurisë.

3. Struktura përgjegjëse për:

a) kryerjen e kontrollit shëndetësor, është Komisioni i Kontrollit Shëndetësor;

b) marrjen e shenjave të gishtave, është Drejtoria e Policisë Shkencore;

c) verifikimin përfundimtar të aplikantit, janë strukturat vendore të burimeve njerëzore, sipas procedurave standarde të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.”

Në nenin 37 “Kontrolli Shëndetësor” të Rregullores së Policisë së Shtetit parashikohet se:

“1. Aplikanti i nënshtrohet kontrollit dhe ekzaminimeve mjekësore pas përfundimit të procesit të testimit. Llojet e vizitave, ekzaminimeve, si dhe rregullat e kryerjes së tyre, përcaktohen në procedurat standarde, të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

2. Procesi i ekzaminimeve mjekësore të aplikantëve, menaxhohet nga Komisioni për Kontrollin Shëndetësor.

3. Për ekzaminime të veçanta, Komisioni vendos për institucionin shëndetësor ku do të kryhet ekzaminimi.

4. Realizimi i kontrolleve dhe ekzaminimeve mjekësore, bëhet sipas marrëveshjes midis Policisë së Shtetit dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm, të Kujdesit Shëndetësor.”

Nga parashikimet e akteve të mësipërme rezulton se kontrolli shëndetësor është një kriter i rëndësishëm i individëve. që duan të bëhen pjesë strukturave të policisë së shtetit. Llojet e ekzaminimeve që bëjnë pjesë në kontrollin shëndetësor parashikohen në procedurat standarde, që janë të miratuara nga Drejtorit i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Mbështetur në parashikimet e neneve 143/5⁴ dhe 145⁵ të Rregullores së Policisë së Shtetit dhe nenit 6, pikat 1⁶ dhe 16⁷ të Ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar rezulton se kursantët që ndjekin arsimin policor pranë Akademisë së Sigurisë gjatë kohës që ndjekin shkollën pranë këtij institucioni të arsimit të lartë, nuk konsiderohen punonjës policie. Marrëdhënia e punës për punonjësin e policisë fillon me aktin e emërimit në detyrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Kontrata që lidhet në momentin e pranimit të aplikantit të shpallur fitues nuk është një kontratë që rregullon marrëdhënien e punësimit, por të drejtat dhe detyrimit e shkollimit.

Për sa më sipër, Procedura Standarde “Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë” është e miratuar me Urdhërin nr. 984, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në bazë të Pikës IV- Procedura, gërma B) “Llojet e vizitave e ekzaminimeve që kryhen në QPM për aplikantët” rezulton se është parashikuar se:

⁴ Neni 143/5 i Rregullores së Policisë përcakton se: “Në momentin e pranimit aplikanti i shpallur fitues, nënshkruan kontratën me titullarin e Akademisë së Sigurisë. Në kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet gjatë shkollimit, si dhe qëndrimi në detyrë, jo më pak se 5 (pesë) vite, pas përfundimit të Akademisë së Sigurisë.”

⁵ Neni 145, i Rregullores së Policisë përcakton se : “Me përfundimin e shkollës bazë të policisë, kursanti pranohet punonjës policie, i jepet grada policore “Inspektor” dhe emërohet në detyrë me urdhët të Drejtorit të Policisë”

⁶ Neni 6, pika 1, e ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar përcakton se: “Emërimi në detyrë është momenti i fillimit të marrëdhënies së punës për punonjësin e policisë

⁷ Neni 6, pika 16, e ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar përcakton se: “Punonjës policie është personi i emëruar në strukturat e policisë pas përfundimit të arsimit policor që mban gradën policore.”

“Krahas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti për gjendjen shëndetësore, Komisioni i Kontrollit Shëndetësor kryen edhe këto vizita:

- A. “Vizita Patologjike (Ekzaminimi klinik, kqyrja fizike)*
- B. Vizita Oftalmologjike (syri i djathtë, syri i majtë, pamje me sy të lirë)*
- C. Vizita ORL (aftësia e veshit të djathtë, aftësia e veshit të majtë)*
- D. Vizita e pneumoftiziatrisë (egzaminimi pulmonar, provat funksionale respiratore)*
- E. Vizita kardiologjike (TA, EKG egzaminime të nevojshme)*
- F. Vizita kirurgjikale*
- G. Vizita për sëmundje infective*
- H. Analizat e gjakut (gjak komplet)*
- I. Analizat biokimike (mëlcia, veshka, sheqerit etj.)*
- J. Grupi i gjakut + Rh faktor*
- K. Antigeni Australia (Hbs)*
- L. Urinë komplet (përfshirë urinë për drogë dhe alkool)*
- M. ”*

Tek Rubrika “Kriteret Shëndetësore” përcaktohen “Kriteret e Përgjithshme të Aplikantëve”. Në pikën 1 të kësaj rubrike parashikohet se: *“Aplikantët duhet të gëzojnë shëndet të plotë dhe nuk duhet të jenë bartës të sëmundjeve kronike apo të sëmundjeve të cilat mund të përsëriten”. Në pikën 5 të saj përcaktohen “Kriteret okulistike”, ku citohet: “Çdo aplikant duhet të ketë shikim 10/10 në çdo sy. Çdo aplikant duhet të jetë në gjendje të dallojë ngjyrat bazë, të përcaktuara me anë të një testi përkatës dhe të ketë fushën vizive normale. Aplikantët duhet të kenë shëndet të plotë, nuk duhet të kenë kryer asnjë operacion të syve, të mos kenë shenja plage rreth syve dhe kapakëve të syve.”*

Mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, është miratuar Urdhëri nr. 888, datë 27.09.2021, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë”*, nëpërmjet së cilit është kryer shpallja e fazës së aplikimeve për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë.

Sipas këtij urdhëri, aplikimet fillojnë në datën 28.09.2021 dhe përfundojnë në datën 27.10.2021. Këto aplikime kryhen pranë Drejtorive Vendore të Policisë, ku aplikantët kanë vendbanimin e tyre. Referuar pikës 4 të tij, rezulton se kuotat e pranimi në Akademinë e Sigurisë, të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e parë dhe të dytë të studimeve të arsimit të lartë, në shkencat juridike, ekonomike ose kompjuterike janë 50.

Në pikën 5 të Urdhërit nr. 888, datë 27.09.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit parashikohet shprehimisht: “5.Kanë të drejtë të aplikojnë shtetsait që plotësojnë kriteret e përgjithshme e të veçanta si vijon:

5.1. Kriteret e përgjithshme janë:

- a. të jetë shtetas shqiptar;
- b. të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, strukturat e tjera të sigurisë kombëtare apo të mos jetë larguar nga shërbimi civil;
- c. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- d. **të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;**
- e. të zotërojë gjuhë shqipe të shkruar dhe të folur;
- f. të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- g. të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B;
- h. të plotësojë kriteret për t;u pajisur me vërtetimin e besueshmërisë.

Për sa më sipër, konstatohet qartë se Urdhëri nr. 888/2021, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit e përcakton shprehimisht se aplikanti duket “**të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën**”, duke e konsideruar kriterin shëndetësor si një ndër kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë aplikantët që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë.

Në pikën 7 të Urdhërit të sipërcituar parashikohen fazat e vlerësimit të aplikantëve. Në këtë pikë përcaktohet se:

“Aplikantët që plotësojnë kriteret dhe paraqesin dokumentacionin e kërkuar i nënshtrohen fazave të vlerësimit si më poshtë:

- a) Vlerësimi sipas notës mesatare të ciklit të dytë të studimeve në të njëjtën fushë studimi;
- b) Vlerësim me testim i zotërimit të gjuhës angleze sipas standardit ALCOT;
- c) Intervistimi i aplikantëve;
- d) Kontrolli shëndetësor;
- e) Marrje e shënjave të gishtave;
- f) Verifikimi përfundimtar i aplikantit.”

Në vijim të urdhërit të sipërcituar, është miratuar Urdhëri nr. 888/1, datë 26.11.2021, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për vlerësimin dhe verifikimin e shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe kanë aplikuar për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë”. Me qëllim kryerjen e një procesi përzgjedhës të drejtë, të paanshëm dhe transparent, sipas parimit të shanseve të barabarta, meritës dhe mosdiskriminimit, nëpërmjet urdhërit të sipërcituar është

urdhëruar fillimi i procesit të vlerësimit, testimi dhe verifikimi të aplikantëve, si dhe është ngritur Komisioni i Vlerësimit prej 5 (pesë) anëtarësh, i cili asistohet nga sekretaria teknike. Në këtë urdhër janë përcaktuar edhe datat e fazave të vlerësimit, sikurse citohet:

“Fazat e vlerësimit dhe verifikimit të aplikantëve, sipas datave janë si më poshtë:

- 1. Vlerësimi, deri në datën 09.12.2021;*
- 2. Vlerësim me testim i njohurive të gjuhës angleze sipas standardit ALCPT, me datën 15.12.2021;*
- 3. Intervistimi, më datën 19.12.2021;*
- 4. Kontrolli shëndetësor, më datën 20.12.2021;***
- 5. Verifikimi përfundimtar i aplikantëve me datën 22.12.2021.”*

Në pikën 4 të këtij Urdhëri përcaktohen shprehimisht dhe me detaje detyrat e komisionit të vlerësimit, të cilat konsistojnë në administrimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të aplikantëve, mbikqyrja e vlerësimit të aplikantëve në njohuritë e gjuhës angleze, mbikqyrja e procesit të kontrollit shëndetësor të aplikantëve dhe mbikqyrja e procesit të marrjes së gjurmëve daktiloskopike. Në pikën 4.4 të Urdhërit parashikohet shprehimisht:

“4.4. Mbikqyr procesin e kontrollit shëndetësor të aplikantëve

- a. Aplikantët e renditur në listë brenda kuotave të shpallura për aplikim i nënshtrohen kontrollit shëndetësor. Kontrolli kryhet nga Komisioni i Kontrollit Shëndetësor përbëhet nga punonjësit:*
 - 1. Drejtues N.Q.;*
 - 2. Mjeku O.P.*
 - 3. Mjeku A.D.*
- b. Komisioni i kontrollit shëndetësor në përfundim të kontrollit shëndetësor i dërgon informacion me shkrim Komisionit të Vlerësimit për aplikantët e kualifikuar dhe skualifikuar. Formulari i kontrollit shëndetësor i dërgohet Komisionit të Vlerësimit për t'u administruar në fashikullin e aplikantit.*
- c. Në rast se gjatë kontrollit shëndetësor aplikantët skualifikohen, Komisioni i Vlerësimit njofton aplikantin e skualifikuar si dhe fton aplikantin e rradhës sipas listës në rend zbritës që t'i nënshtrohen procesit të kontrollit shëndetësor.*
- d. Gjatë kontrollit shëndetësor, aplikanti i nënshtrohet edhe matjes së gjatësisë si kriter i veçantë për aplikim”*

Në pikën 11, germa a), të Urdhërit nr. 888/1, datë 26.11.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit *“Për vlerësimin dhe verifikimin e shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe kanë aplikuar për t'u pranuar në Akademinë e Sigurisë”* është parashikuar se:

“11.Verifikimi përfundimtar i aplikantëve.

- a. Aplikantët që kalojnë me sukses procesin e kontrollit shëndetësor, marrjes së gjurmëve daktiloskopike dhe intervistimit i nënshtrohen procesit të verifikimit përfundimtar të vlerësimit të besueshmërisë”.

Për sa më sipër, rezulton se kriteri shëndetësor është i përcaktuar si kriter i përgjithshëm, edhe në fazat e kualifikimit dhe testimit të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë. Në bazë të Procedurës Standarde “Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë”, të miratuar me Urdhërin nr. 984, datë 17.12.2015, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kontrolli shëndetësor parashikon edhe vizitën okulistike, si dhe kriterin e shikimit 10/10 të aplikantëve, që kualifikohen për në Akademinë e Sigurisë.

KMD ka analizuar edhe Njoftimin e publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, lidhur me hapjen e aplikimeve për pranimin në Akademinë e Sigurisë për student që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë me mesatare të notave mbi 8, për disa degë të caktura.

Në këtë njoftim, tek rubrika e “Kritereve të Përgjithshme” është përcaktuar se një prej tyre është edhe kriteri “të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën”. Ky kriter lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me parashikimin e pikës 5 të Procedurës Standarde “Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë”, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ku parashikohet kriteri i shikimit 10/10.

Referuar shkresës nr. 1/1530, datë 01.12.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit drejtuar Akademisë së Sigurisë rezulton se mbi bazën e aplikimeve të depozituara në Drejtorinë Vendore të Policisë rezulton se numri i shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve dhe kanë aplikuar për pranim në Akademinë e Sigurisë është 79 të tillë.

Ankuesi A.P. është njëri prej aplikantëve të sipërcituar. Ai ka përfunduar në vitin 2018, studimet Bachelor për “Shkenca Juridike në Biznes” pranë Fakultetit Ekonomik, të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Në vijim, ankuesi ka përfunduar studimet në programin Master Profesional në të Drejtën Publike pranë Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës dhe është diplomuar në muajin korrik të vitit 2021. Mbështetur në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ankuesi ka aplikuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, për t’u pranuar pranë Akademisë së Sigurisë, si student që ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë me mesatare të notave mbi 8 (tetë).

Pas kalimit të fazave paraardhëse, kandidatët e kualifikuar për pranim në Akademinë e Sigurisë, ndër të cilët edhe z. A.P., janë testuar edhe në fazën e kontrollit mjekësor. Instanca që merret me ekzaminimet mjekësore të punonjësve të Policisë së Shtetit është Qendra e Profilaksi Mjekimit

(QPM), e konkretisht Sektori i Profilasi Mjekimit, ku në rastet e testimit ky sektor vepron si Komision i Kontrollit Shëndetësor. Ky komision përbëhet nga 3 mjekë dhe vendimmarrja e tyre është kolektive.

Referuar Procesverbalit *“Mbi shpalljen nga ana e Komisionit të Kontrollit Mjekësor të kandidatëve që kalojnë në fazat e tjera të konkurrimit për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë”* të mbajtur nga Komisioni Mjekësor rezulton se: *“Komisioni filloi punë me datën 20.11.2021, në orën 8.00 me marrje e Analizave laboratorike. Në kontrollin mjekësor janë kryer këto ekzaminime: Vizitë patologjike, Okulistike (mprehtësia e pamjes), Pneumoftiziatrisë, Shërbimi i kardiologjisë (matja e tensionit arterial, Spo2 dhe pulsi arterial), shërbimi i kirurgjisë, analizat laboratorike, gjak komplet urinë komplet testin e drogës dhe të Hepatit B (HbsAg). Janë paraqitur në procesin e kontrollit shëndetësor 49 aplikantë, nga të cilët 29 aplikantë kanë kaluar kontrollin mjekësor, 9 aplikantë janë skualifikuar për gjatësi trupore, 4 janë skualifikuar për probleme me sytë, 6 (gjashtë) aplikantë me tatuazh dhe 1 (një) i skualifikuar me tatuazh dhe për probleme me sytë....”*

Pas përfundimit të analizave laboratorike dhe ekzaminimeve mjekësore, Komisioni Mjekësor në mënyrë unanime vendosi mbi listën e aplikantëve fitues që janë 29 të tillë, si dhe listën e aplikantëve të skualifikuar që janë 20 të tillë, ndër të cilët 4 (katër) aplikantë janë skualifikuar për shkak të problemeve me shikimin e tyre. Njëri ndër ta ishte edhe ankuesi A.P., shikimi i të cilit rezultoi me probleme.

Për sa më sipër, rezuton se skualifikimi i katër aplikantëve të sipërcituar, ndër të cilët edhe ankuesi A.P., është kryer në bazë të pikës 5 të Rregullores së Shërbimit Shëndetësor nr. 983, datë 17.12.2015, të Policisë së Shtetit, ku citohet: *“Çdo aplikant duhet të ketë shikim 10/10 në çdo sy....”*

Për sa më sipër, Komisioni i Kontrollit Shëndetësor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, u shpreh me vendimin nr. 11, datë 22.12.2021, ku vendoset skualifikimi i aplikantit A.P., pasi konsiderohet si i paafte për të vazhduar Akademinë e Sigurisë, për arsye se ka probleme me sytë OD 7/10 dhe OS 7/10.

Mbështetur në nenin 141 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, ku parashikohet procesi i ankimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë, si dhe në pikën 7, të Urdhërit nr. 888/1, datë 26.11.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ankuesi e kundërshtoi vendimin e sipërcituar në Komisionin e Apelimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ky komision pas kryerjes së verifikimeve përkatëse të skedës mjekësore nr. regj. 2, datë 22.12.2021, u shpreh me vendimin nr. 322, datë 30.12.2021, nëpërmjet së cilit vendosi rrëzimin e kërkesës së z. A.P., pasi nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Pikën 4.4 të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 888, datë 27.09.2021, si dhe Procedurës Standarde *“Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë”*, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në pikën 2, të nenit 140 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, është përcaktuar se: *“Aplikanti në rast se nuk kalon një nga fazat e konkurrimit, sipas rendit të përcaktuar në nenin 135 të kësaj rregulloreje, humbet të drejtën për kalimin në fazën tjetër të konkurrimit dhe skualifikohet”*. Në këtë kontekst, rezulton se në kushtet kur, z. A.P. nuk kaloi njërin prej fazave të konkurrimit, që është ajo e kontrollit shëndetësor, për shkak të problemeve me shikimin në të sytë, ai është skualifikuar nga konkurrimi për në Akademinë e Sigurisë.

Ankuesi e kundërshtoi gjyqësisht vendimin nr. 322, datë 30.12.2021, e Komisionit të Apelit, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila është shprehur me vendimin nr.867, datë 23.03.2022, nëpërmjet së cilit ka rrëzuar kërkesëpadinë e z. A.P..

Për sa më sipër, lidhur me pretendimin e ankuesit A.P. se kriteri i shikimit është i vlefshëm vetëm për kandidatët për programin e patrullës së përgjithshme dhe jo për programin e ekselencës ku ai ka aplikuar, Komisioneri gjykon se nga analizimi i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, ky kriter qëndron edhe për kategorinë e aplikantëve, ku bën pjesë ankuesi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, KMD ka konstatuar se Komisioni i Kontrollit Shëndetësor ka vepruar konform parashikimeve të Procedurës Standarde *“Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë”*, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në Vendimin nr. 11, datë 22.12.2021, e këtij Komisioni vendoset skualifikimi i aplikantit A.P., pasi konsiderohet si i paafët për të vazhduar Akademinë e Sigurisë, për arsye se ka probleme me sytë OD 7/10 dhe OS 7/10, pasi në rregulloren e sipërcituar është parashikuar shprehimisht fakti se aplikanti duhet të përmbushë kriterin e shikimit 10/10, pra të ketë shikim maksimal.

Në nenin 140, të Rregullores së Akademisë së Sigurisë⁸, përcaktohet se Akademia e Sigurisë është struktura përgjegjëse për menaxhimin e procesit të konkurrimit. Ky parashikim bie në

⁸ Neni 40, i Rregullores së AS: *1. Pranimi në një nga programet e studimit në Akademinë e Sigurisë, bëhet nëpërmjet procesit të konkurrimit. Ky proces përmban një sërë testesh të cilët synojnë të verifikojnë aftësitë dhe cilësitë e konkurrenteve për të qenë pjesëtarë të Policisë së Shtetit, për të marrë përsipër dhe realizuar detyrat në mbrojtje të rendit, sigurisë publike dhe luftës ndaj krimit. 2. AS-ja është struktura përgjegjëse për menaxhimin e procesit të konkurrimit. Ajo organizon dhe realizon teste të ndryshme që verifikojnë e vlerësojnë dijet, njohuritë dhe zhvillimin intelektual, nëpërmjet testimit me shkrim; gjendjen, cilësitë dhe aftësitë fizike nëpërmjet provave dhe ushtrimeve vlerësuese, si dhe testimi psikologjik me anë të intervistës me gojë. 3. Konkurimi për pranimin në Kolegjin e Policisë, rjedhimisht në Policinë e Shtetit, i cili bazohet kryesisht në testimin me shkrim, provat e aftësive fizike dhe testimi psikologjik, ndërtohet në pershtatje me nivelet dhe ciklet e studimeve për të cilat aplikohet.....5. **Procesi i konkurimit për pranimin në Policinë e Shtetit, për ecurinë në karrierë, për fillimin e studimeve në nivele të ndryshme shkollimi e kualifikimi, etj., është i normuar me anë të procedurave standarde të konkurrimit.***

kundërshtim me nenin 136 të Rregullores së Policisë së Shtetit dhe krijon përshtypjen se Akademia e Sigurisë është përgjegjëse për menaxhimin e gjithë procesit të konkurimit. Fillimisht edhe ankuesi e ka drejtuar ankesën e tij vetëm kundër Akademisë së Sigurisë. Gjatë hetimit administrativ KMD shtoi si subjekt edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila në bazë të nenit 136 të Rregullores së Policisë së Shtetit është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të pranimit në Akademinë e Sigurisë. Në mënyrë të posaçme faza e kontrollit shëndetësor sipas kësaj dispozite realizohet nga Komisioni i Kontrollit Shëndetësor, strukturë kjo e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se problematika e çështjes së parashtruar nga ankuesi qendron tek parashikimi i Rregullores së sipërcituar, mbi parashikimin e së cilës janë mbështetur vendimi nr. 11, datë 22.12.2021, i Komisionit të Kontrollit Shëndetësor dhe vendimi nr. 322, datë 30.12.2021, i Komisionit të Apelit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit sqaroi se kriteri i shikimit 10/10 për aplikantët që konkurojnë në Akademinë e Sigurisë ka patur si synim faktin që ata të kenë shikim të saktë, pasi në përfundim të kësaj Akademie, gjatë kohës kur ata do të jenë në shërbim, mund të gabojnë shënjestrën. Përfaqësuesi i Akademisë së Sigurisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit u pyet nga përfaqësuesit e KMD-së, nëse aktualisht ka oficerë policie në detyrë, të cilët kanë problematika me shikimin dhe janë të pajisur me syze. Ai pohoi faktin se ka të tillë dhe u shpreh se punonjës nuk lejoheshin të punonin në terren, por kryenin punë me natyrë administrative.

Në pikën 19 të Urdhërit nr. 888/2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohet se: *“Aplikanti që përfundon me sukses trajnimin në Akademinë e Sigurisë, nënshkruan kontratë pune me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe emërohet në strukturat vendore të policisë, sipas nevojave të Policisë së Shtetit”.*

Në bazë të pikës 2, gërma b), të nenit 46 *“Ndërprerja e marrëdhënieve të punës të punonjësit të policisë”*, të ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Punonjësi i policisë ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet nga policia.

2. Punonjësi i policisë lirohet nga policia në rastet kur:

a) mbush moshën për pension pleqërie;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;

.....”.

Në nenin 51, të Rregullores së Policisë së Shtetit parashikohet shprehimisht se:

1. Cdo punonjës policie, kryen kontroll shëndetësor periodik jo më pak së një herë në vit. Punonjësit e policisë të strukturave operacionale dhe speciale, e kryejnë kontrollin çdo gjashtë muaj.
2. Kontrollat shëndetësore periodike të punonjësve të policisë kryhen pranë njësive të tyre policore.
3. Llojet e kontrollit, ekzaminimeve mjekësore, kategoritë e personelit sipas shërbimeve policore, rregullat dhe procedurat e kryerjes, përcaktohen me procedurë standarde të miratuar nga Drejtori i Policisë së Shtetit.
4. Realizimi i kontrolleve dhe ekzaminimeve mjekësore bëhet sipas marrëveshjes midis Policisë së Shtetit dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
5. Të gjithë punonjësit e policisë kartelizohen sipas sistemit të evidencës shëndetësore. Kartelat plotësohen dhe administrohen nga shërbimi i Profilaksisë dhe Mjekimit, të cilat struktura përgjegjëse për menaxhimin e procesit të shërbimit shëndetësor në Policinë e Shtetit.
6. Shërbimi i profilaksisë dhe mjekimit, pas përfundimit të kontrolleve periodike si dhe në raste të tjera të veçanta, informon Drejtorin e Burimeve Njerëzore mbi problematikat dhe gjendjen shëndetësore të punonjësve të policisë.
7. Për punonjësit e policisë që rezultojnë të paaftë nga ana shëndetësore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore i propozon Drejtorit të Policisë Shtetit lirim nga Policia e Shtetit dhe për procedurat e trajtimit të mëtejshëm.”

Në shkresën nr.3586/1, datë 24.05.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit citohet: “Lidhur me kriterin 10/10 nëse vlen edhe për oficerët e policisë që janë në detyrë, procedura standarde e sipërcituar, janë për aplikantët që rekrutohen në strukturat e policisë së Shtetit, ndërkohë që për punonjësit e policisë të cilët mund të kenë diagnoza të ndryshme shëndetësore trajtohen sipas ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor” dhe (KEMP).”

Në këtë shkresë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në asnjë rast nuk është shprehur se punonjësit e policisë që kanë rezultuar të paaftë nga kontrolli okulistik vjetor ose për arsye të ndryshme shëndetësore janë larguar nga puna dhe nuk ka evidentuar raste të tilla, sikurse parashikon Rregullorja e Policisë së Shtetit.

Për sa më sipër, KMD gjykon se pavarësisht se shikimi është një kriter i rëndësishëm përbërës i kriterit të përgjithshëm shëndetësor, për kandidatët që aplikojnë në Akademinë e Sigurisë, sërish përcaktimi i tij në standardin 10/10 sipas pikës 5, të Procedurës Standarde “Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë”, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, të

Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është jo praktik dhe i përshtatshëm. Kandidatët që pranohen në Akademinë e Sigurisë me shikim 10/10, mund të kenë rënie të këtij shikimi në vitet vijuese, por nga praktika nuk rezulton se për këtë shkak të jenë liruar nga detyra, por përkundrazi sikurse është pohuar nga përfaqësuesi i subjekteve këta punonjës janë sistemuar në pozicione pune të natyrës administrative.

Si pasojë e këtij përcaktimi në Procedurat Standarde, ankuesi A.P. u skualifikua duke patur një shikim 7/10 në të dy sytë, ndërkohë që ka rezultuar kalues në fazat e tjera paraardhëse të Akademisë së Sigurisë. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se kriteri përjashtues i përcaktuar në Procedurat Standarte për Pranimin në Akademinë e Sigurisë, Kreu IV “Kriteret shëndetësore”, pika 5 “Kritere Okulistike”⁹, i cili përjashton aplikantët që rezultojnë me shikim më të ulët se 10/10, kufizon të drejtën për arsim të ankuesit. Komisioneri vlerëson se ky kufizim nuk është një kufizim që ka të bëjë me kritere të meritës apo aftësisë dhe se parashikimi në Procedurat Standarte kanë cënuar aspekte të tilla të rëndësishme si aksesueshmëria dhe parashikueshmëria që duhet të përmbushë akti ligjor që ndërhyr në të drejtat dhe liritë e individit.

Në kontekst të së drejtës për arsim, KMD ka analizuar hollësisht Urdhërin nr. 888, datë 27.09.2021, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë”*, nëpërmjet së cilit është kryer shpallja e fazës së aplikimeve për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë. Në pikën 4 të tij, përcaktohet se: *“Kuotat e pranimit në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e parë dhe të dytë të studimeve të Arsimit të lartë, në shkencat juridike, ekonomike ose kompjuterike janë 50”*. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se për sa kohë që për një aplikim të tillë kërkohet që aplikantët të jenë të diplomuar dhe të profilizuar në tre degë të tilla si shkencat juridike, ekonomike dhe kompjuterike, të cilët gjithashtu duhet të jenë studentë ekselence, krijohet bindja se një kategori e tillë punonjësisht policie, me një nivel të caktuar intelektual dhe në fushat e arsimit të specifikuar, do të shërbejë për rritjen e standardit të institucionit të Policisë së Shtetit, duke kryer kryesisht punë të natyrës administrative. Njëkohësisht, në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se nuk mund të kufizohet e drejta për arsim e aplikantëve të kategorisë së sipërcituar, mbështetur në kriterin e shikimit 10/10, i cili mund të jetë i kriteri i vlefshëm për punësim në Policinë e Shtetit apo për punonjësit e policisë në detyrë, por jo për ata që duan të ndjekin arsimin në këtë Akademi. Prandaj në këtë aspekt, kriteri i vendosur është jo proporcional dhe nuk ndjek një përligjje të arsyeshme.

Në kontekst të së drejtës për punësim, KMD gjykon se në përfundim të këtij institucioni arsimor, të diplomuarit jo domosdoshmërisht do të punojnë për Policinë e Shtetit, pasi punësimi pranë një

⁹ Miratuar me Urdhrin nr. 984 datë 17.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

institucioni të tillë, është një moment i dytë dhe mbështetet në një akt ku shprehet vullneti i dyanshëm i palëve. Por, edhe nëse vendosin të aplikojnë për një vend pune pranë këtij institucioni, mund të përzgjedhin aplikim për një pozicion pune me natyrë administrative. Në këto kushte, KMD gjykon se kriteri i shikimit 10/10 për këtë kategori aplikantësh passjell cënim të së drejtës për arsim.

Komisioneri çmon se Akademia e Sigurisë kundër të cilës është drejtuar ankesa e z. A.P., nuk ka kryer veprime, të cilat kanë çenuar të drejtën për akses të barabartë në arsim të ankuesit. Përgjegjësia i takon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi kriteri skualifikues është përcaktuar në Procedurat Standarde *“Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë”*, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Pikërisht, një kriter i tillë e ka ekspozuar ankuesin ndaj një qendrimi të padrejtë e disfavorizues, duke e skualifikuar nga konkurrimi në Akademinë e Sigurisë.

B.Shkaku i mbrojtur “gjendja shëndetësore”.

Z. A.P. pretendon diskriminim për shkak të *“gjendjes shëndetësore”*, nga ana e Akademisë së Sigurisë.

“Gjendja Shëndetësore” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të *“gjendjes shëndetësore”*, Komisioneri gjykon se *“gjendja shëndetësore”* konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Ankuesi ka depozituar gjithashtu në cilësi prove të skedës mjekësore nr. 2 dhe kopjes së vendimit të Komisionit Shëndetësor, pranë Akademisë së Sigurisë, sipas së cilit rezulton se z. A.P. ka probleme me sytë në vizusin e syrit të majtë, sipas diagnozës (OS 7/10 dhe OD – 7/10 OU 7/10).

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur –gjendja shëndetësore.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se z. A.P. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, pasi i është cënuar e drejta për arsim nga parashikimi i pikës 5 të aktit Procedurat Standarde “*Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë*”, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore, që i garantohet individit lidhur me shkakun e gjendjes shëndetësore, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 57 të Kushtetutës sipas të cilit “*Kushdo ka të drejtën për arsimim*”. Njëkohësisht, neni 18, pika 2, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: “*Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.*” Kushtetuta ka përcaktuar gjithashtu, se arsimi i lartë mund të kufizohet vetëm mbi bazën e kriterit të aftësisë.

Në përputhje me Kushtetutën edhe ligji “Për arsimin e lartë” përcakton se barazia e shanseve dhe mundësive garantohet mbi bazën e meritës. Pakti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore shpjegon në Komentin e Përgjithshëm Nr. 13, së “*aftësia*” e individëve vlerësohet duke ju referuar të gjitha ekspertizave dhe eksperiencave përkatëse¹⁰. Kriteri i shikimit 10/10, i vendosur si pjesë e kontrollit shëndetësor, që përcaktohet në pikën 5 të Procedurave Standarde të Policisë së Shtetit për aplikantët në Akademinë e Sigurisë, në vlerësimin e Komisionerit nuk ka të bëjë me aspekte të eksperiencave dhe ekspertizës, që duhet të posedojë aplikanti, aspekte të cilat shërbejnë për të vlerësuar aftësinë e tij. Nëse i referohemi legjislacionit të zbatueshëm për arsimin e lartë, i zbatueshëm në rastin konkret pasi Akademia e Sigurisë është një institucion i arsimit të lartë, nuk ka asnjë kriter përjashtues për personat me shikim më të ulët se 10/10, që duan të ndjekin arsimin e lartë pranë institucioneve arsimore.

Gjithashtu neni 1¹¹ i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) siguron mbrojtje kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave të përcaktuara me ligj, si dhe afirmon ndalimin e

¹⁰ Komenti i Përgjithshëm nr. 13, paragrafi 19.

¹¹ Neni 1, Protokolli 12 i KEDNJ, parashikon shprehimisht: “*1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose*

diskriminimit nga ana e autoriteteve publike. Në interpretim të nenit të kësaj konvente, një person është i diskriminuar, për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 14 të KEDNJ-së¹², nëse nga sjellja (veprimi ose mosveprimi) e autoriteteve shtetërore, i mohohet gëzimi i të drejtave, që legjislacioni kombëtar i njeh individëve në mënyrë specifike, të cilat rrjedhin nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas legjislacionit kombëtar, nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional, si dhe nga çdo veprim ose mosveprim tjetër i një autoriteti publik¹³. Megjithatë jo shprehimisht e përfshirë në listën e shkaqeve të mbrojtura të KEDNJ-së, gjendja shëndetësore është përfshirë nga GJEDNJ-ja në interpretimin e shkaqeve “të tjera” sipas nenit 14.

Neni 2/2 i Paktit Ndërkombëtar “Për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”, garanton mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Qëndrimi i shprehur në Komentin e Përgjithshëm nr. 20 datë 02.07.2009 për mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore (KDESK), është se termi shkaqe “të tjera” mund të interpretohet në mënyrë të tillë që të përfshijë “gjëndjen shëndetësore”, përfshirë këtu jetesën apo statusin me HIV. Në Komentin e Përgjithshëm nr. 20, datë 02.07.2009, KDESK shprehet se, gjendja shëndetësore i referohet shëndetit fizik ose mendor të personit.

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka miratuar më datë 19.09.2001, Rekomandimin (2001)10 “Mbi Kodin Evropian të Etikës së Policisë”. Ndër të tjera në këtë dokument përcaktohen standarte në lidhje me kualifikimet dhe rekrutimin e personelit të policisë. Në paragrafët 22, 23, dhe 25 të këtij rekomandimi përcaktohet se: “22. Personeli i policisë, në çdo nivel të hyrjes, do të rekrutohet në bazë të kualifikimeve dhe përvojës së tyre personale, e cila do të jetë e përshtatshme për objektivat e policisë. 23. Personeli i policisë duhet të jetë në gjendje të tregojë gjykim të shëndoshë, një qëndrim të hapur, pjekuri, drejtësi, aftësi komunikimi dhe, kur është e përshtatshme, aftësi drejtuese dhe menaxhuese. Për më tepër, ata duhet të kenë një kuptim të mirë të çështjeve sociale, kulturore dhe komunitare.25 Procedurat e rekrutimit bazohen në baza objektive dhe jodiskriminuese, pas shqyrtimit të nevojshëm të kandidatëve.....”.

çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”

¹² Neni 14, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut parashikon shprehimisht se: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

¹³ Shih Sejdic dhe Finci kundër Bosnjë-Hercegovinës (2009); Savez Crkava “Rijec Zivota” dhe të tjerët kundër Kroacisë nr. 7798/08, § 58, 9 dhjetor 2010);

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Në mënyrë të posaçme LMD, i ndryshuar, parashikon mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e arsimit në Kreun III. LMD, i ndryshuar, në nenin 17/1/ç¹⁴, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që bazohet në gjendjen shëndetësore, që i bëhet një personi në gëzimin e të drejtës për arsim, duke përfshirë këtu pranimin në institucion arsimor. Bazuar në nenin 17/2 të LMD, të ndryshuar, ndalohet t’i refuzohet një personi ose grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik për shkak të gjendjes shëndetësore, si një nga shkaqet e mbrojtura nga neni 1, i ligjit.

Kodi i Procedurës Administrative ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Drejtorisë së Përgjithshme të policisë së Shtetit, e cila duhet të provojë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

LMD, i ndryshuar, ka saktësuar gjithashtu se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që duhet të provojë se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues për shkak të gjendjes së tij, shëndetësore.

¹⁴ Neni 17/1/c/ç, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.”

Neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, përcakton se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS¹⁵ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁶

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet, kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa*

¹⁵ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹⁶ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law2018_en.pdf, fq.232.

kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht¹⁷”.

Për sa më sipër, mbështetur në provat dhe faktet e administruara KMD vlerësoi se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, kundrejt shtetasit A.P. dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt.

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të depozituara nga ankuesi dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e këtij subjekti, pasi ankuesit i është cënuar e drejta për arsim, pasi është skualifikuar nga konkurrimi në Akademinë e Sigurisë, nga ana e Komisionit të Kontrollit Shëndetësor, strukturë kjo e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi nuk plotësonte kriterin e shikimit 10/10. Parashikimi lidhur me kriterin e shikimit 10/10, të aplikantëve që konkurrojnë pranë Akademisë së Sigurisë, është parashikuar në pikën 5, të Kriterëve Shëndetësorë, tek Procedurat Standarde “*Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë*”, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ankuesi A.P. e mbart shkakun e gjendjes shëndetësore, fakt që rezulton nga skeda e tij mjekësore, ku rezulton i dokumentuar kontrolli mjekësor i shikimit të tij 7/10 në të dy sytë, akt ky i depozituar në cilësi provë nga ana e tij dhe e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Njëkohësisht, akte provuese për sa më sipër, janë edhe vendimi nr. 11, datë 22.12.2021, i Komisionit të Kontrollit Shëndetësor, ku vendoset skualifikimi i aplikantit A.P., pasi konsiderohet si i paaftë për të vazhduar Akademinë e Sigurisë, për arsye se ka probleme me sytë OD 7/10 dhe OS 7/10, si dhe vendimi nr. 322, datë 30.12.2021, i Komisionit të Apelit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Gjatë hetimit administrativ të çështjes, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka sqaruar se mbështetur në Urdhërin nr. 888/1, datë 26.11.2021, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është ngritur Komisioni Shëndetësor, pranë Akademisë së Sigurisë, që ka konstatuar se kandidati për pranim, shtetasi Alban Vangjel A.P. ka problem me sytë, në vizusin e syrit të majtë, sipas diagnozës (OS 7/10 dhe OD – 7/10 OU 7/10). Mbështetur në Procedurat Standarde të Pranimit në Akademinë e Sigurisë, të miratuara me Urdhërin nr. 948, datë 17.12.2015, e

¹⁷ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Komisioni Shëndetësor citon se: “Çdo aplikant duhet të ketë shikim 10/10 në çdo sy” “Çdo aplikant duhet të jetë në gjendje të dallojë ngjyrat bazë, të përcaktuara me anë të një testi si dhe të ketë fushë vizive normale”. Komisioni Shëndetësor, me Vendimin nr. 11, datë 22.12.2021, vendosi: “Aplikanti A.P. nuk kualifikohet për të vazhduar në fazat e tjera për në Akademinë e Sigurisë, pasi konsiderohet i paaftë për të vazhduar studimet në Akademinë e Sigurisë. Gjatë rekrutimit të aplikantëve, ata duhet të kenë shëndet të plotë, nuk duhet të kenë kryer asnjë operacion në sy, të mos kenë shenja, plagë rreth syve dhe të kapakëve të syve.” Në vijim, Komisioni i Apelit, i ngritur me Urdhërin nr. 888/1, datë 26.11.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për vlerësimin dhe verifikimin e shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studentëve të arsimit të lartë dhe kanë aplikuar për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë”, pasi ka shqyrtuar ankimin e paraqitur, ka vendosur se: “Aplikanti z. Alban Vangjel A.P. nuk plotëson kriterin e shikimit”. Në këto kushte, mbështetur në pikën 4/4 të Urdhërit nr. 888, datë 27.09.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të Arsimit të Lartë”, si dhe Procedurën Standarde “Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të Policisë”, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, kanë vendosur rrëzimin e ankesës së z. A.P., pasi nuk plotëson kriteret e mësipërme.

Në prapësimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në asnjë rast nuk është dhënë shpjegim se përse është i nevojshëm kriteri i shikimit në parametra të tillë, mbi bazën e së cilës është bërë edhe përcaktimi i sipërcituar në Procedurat Standarde të Policisë së Shtetit. I vetmi shpjegim lidhur me këtë fakt është dhënë nga përfaqësuesi i këtij institucioni në seancën dëgjimore të zhvilluar pranë KMD-së, ku u shpreh se kriteri i shikimit 10/10 vlen pasi punonjësi i policisë duhet të jetë i saktë në shënjestrën e marrë. Ndërkohë që ky standard për kriterin e shikimit nuk vlen në të njëjtin nivel për oficerët e policisë në detyrë.

Në shkresën nr.3586/1, datë 24.05.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit citohet: “Lidhur me kriterin 10/10 nëse vlen edhe për oficerët e policisë që janë në detyrë, procedura standarde e sipërcituar, janë për aplikantët që rekrutohen në strukturat e policisë së Shtetit, ndërkohë që për punonjësit e policisë të cilët mund të kenë diagnoza të ndryshme shëndetësore trajtohen sipas ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor” dhe (KEMP).” Në këtë shkresë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në asnjë rast nuk është shprehur se punonjësit e policisë që kanë rezultuar të paaftë nga kontrolli okulistik vjetor ose për arsye të ndryshme shëndetësore janë larguar nga puna dhe nuk ka evidentuar raste të tilla, sikurse parashikohet në pikën 2, gërma b), të nenit 46 “Ndërprerja e marrëdhënieve të punës të punonjësit të policisë”, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar Rregullorja e Policisë së Shtetit dhe nenin 51, të Rregullores së Policisë së Shtetit.

Në këtë kontekst, KMD gjykon se pavarësisht se shikimi është një kriter i rëndësishëm përbërës i kriterit të përgjithshëm shëndetësor, për kandidatët që aplikojnë në Akademinë e Sigurisë, sërish përcaktimi i tij në standardin 10/10 sipas pikës 5 të Procedurës Standarde *“Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë”*, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është jo praktik dhe i përshtatshëm. Kandidatët që pranohen në Akademinë e Sigurisë me shikim 10/10, mund të kenë rënie të këtij shikimi në vitet vijuese, por nga praktika nuk rezulton se për këtë shkak të jenë liruar nga detyra, por përkundrazi sikurse është pohuar nga përfaqësuesi i subjekteve këta punonjës janë sistemuar në pozicione pune të natyrës administrative. Si pasojë e këtij përcaktimi në Procedurat Standarde, ankuesi A.P. u skualifikua duke patur një shikim 7/10 në të dy sytë, ndërkohë që ka rezultuar kalues në fazat e tjera paraardhëse të Akademisë së Sigurisë. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se kriteri përjashtues i përcaktuar në Procedurat Standarte për Pranimin në Akademinë e Sigurisë, Kreu IV *“Kriteret shëndetësore”*, pika 5 *“Kritere Okulistike”*¹⁸, i cili përjashton aplikantët që rezultojnë me shikim më të ulët se 10/10, kufizon të drejtën për arsim të ankuesit. Komisioneri vlerëson se ky kufizim nuk është një kufizim që ka të bëjë me kritere të meritës apo aftësisë dhe se parashikimi në Procedurat Standarte kanë cënuar aspekte të tilla të rëndësishme si aksesueshmëria dhe parashikueshmëria që duhet të përmbushë akti ligjor që ndërhyr në të drejtat dhe liritë e individit.

Në aspektin e së drejtës për arsim, KMD ka analizuar hollësisht Urdhërin nr. 888, datë 27.09.2021, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *“Për shpalljen e aplikimit për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë”*, nëpërmjet së cilit është kryer shpallja e fazës së aplikimeve për pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë. Në pikën 4 të tij, përcaktohet se: *“Kuatat e pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasve që kanë përfunduar ciklin e parë dhe të dytë të studimeve të Arsimit të lartë, në shkencat juridike, ekonomike ose kompjuterike janë 50”*. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se për sa kohë që për një aplikim të tillë kërkohet që aplikantët të jenë të diplomuar dhe të profilizuar në tre degë të tilla si shkencat juridike, ekonomike dhe kompjuterike, të cilët gjithashtu duhet të jenë studentë ekselence, krijohet bindja se një kategori e tillë punonjësish policie, me një nivel të caktuar intelektual, do të shërbejë për rritjen e standardit të institucionit të Policisë së Shtetit, duke kryer kryesisht punë të natyrës administrative. Njëkohësisht, në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se nuk mund të kufizohet e drejta për arsim e aplikantëve të kategorisë së sipërcituar, mbështetur në kriterin e shikimit 10/10, i cili mund të jetë i kriteri i vlefshëm për punësim në Policinë e Shtetit apo për punonjësit e policisë në detyrë, por jo për ata që duan të ndjekin arsimin në këtë Akademi. Në këto kushte, KMD gjykon se kriteri i shikimit 10/10 për këtë kategori aplikantësh passjell cënim të së drejtës për arsim.

¹⁸ Miratuar me Urdhërin nr. 984 datë 17.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

E parë në aspektin e punësimit, KMD gjykon se në përfundim të këtij institucioni arsimor, të diplomuarit jo domosdoshmërisht do të punojnë për Policinë e Shtetit, pasi punësimi pranë një institucioni të tillë, mbështetet në një akt ku shprehet vullneti i dyanshëm i palëve. Por, edhe nëse vendosin të aplikojnë për një vend pune pranë këtij institucioni, mund të përzgjedhin aplikim për një pozicion pune me natyrë administrative. Pozicionimi i punonjësve të policisë së shtetit në detyrë në pozicione pune të natyrës administrative, kur shikimi i tyre nuk është në parametrat 10/10 është një fakt i pohuar edhe gjatë seancës dëgjimore që Komisioneri zhvilloi për shqyrtimin e kësaj ankese.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në asnjë rast nuk u arrit të provohej që për veprimet dhe mosveprimet e këtyre subjekteve kundrejt ankuesit kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprimeve dhe mosveprimeve ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me anë të përcaktimit të kriterit të shikimit 10/10, në Procedurat Standarde, miratuar me Urdhrin nr. 984 datë 17.12.2015, e Drejtorit të Policisë së Shtetit, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese ankuesin A.P., duke i mohuar të drejtën për arsim, për shkak të gjendjes shëndetësore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 7, nenin 17, pika 2, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, në të drejtën për arsim, të ankuesit A.P., për shkak të gjendjes shëndetësore, si pasojë e parashikimit të kriterit skualifikues të shikimit 10/10, të parashikuar në Kreun IV, *“Kriteret Shëndetësore”*, *“Kriteret e Përgjithshme për Aplikantët”*, pika 5 *“Kritere okulistike”*, të Procedurave Standarde *“Për kujdesin dhe profilaksinë e shëndetit të punonjësit të policisë”*, miratuar me Urdhërin nr. 983, datë 17.12.2015, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Konstatimin e mosdiskriminimit, në të drejtën për arsim, të ankuesit A.P., për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e Akademisë së Sigurisë.
3. Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për heqjen e kriterit skualifikues të shikimit 10/10 për pranim në Akademinë e Sigurisë, për aplikantët që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
5. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – arsim
Shkak – gjendja arsimore
Lloji i vendimit - Diskriminim